



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 16.3.2022

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË STATISTIKAVE
ZYRTARE 2022-2026”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 16 mars 2022, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë projektligj, znj. Anila Denaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Instituti i Statistikave:

- Znj. Elsa Dhuli, Drejtore e Përgjithshme;
- Z. Maldi Dema, Drejtor i Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore;
- Znj. Helda Mitre, Drejtore e IT dhe Grumbullimit të të Dhënave;
- Znj. Elona Sevrani, Drejtore e Prodhimit Statistikor.

II. Baza ligjore.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës. Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Bashkëlidhur projektligjit paraqitet Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026.

III. Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i objektivave zhvillimore të Sistemit Kombëtar Statistikor, aktiviteteve statistikore, afateve të zbatimit, përgjegjësi të institucioneve prodhuese statistikore dhe institucioneve furnizuese me të dhëna statistikore për periudhën 2022-2026 në Republikën e Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve që lindin nga ligji nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026 hartohet në zbatim të neneve 7 dhe 8 të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”. Sipas këtyre dispozitave, Programi i Statistikave Zyrtare duhet të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, për periudhën pesëvjeçare dhe duhet të përmbajë aktivitetet statistikore kryesore, të cilat duhet të kryhen nga prodhuesit e statistikave zyrtare gjatë kësaj periudhe.

Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026 përbëhet në total nga 9 kapituj, për të cilat pasqyrohen informacione të detajuara në anekset përkatëse, që i bashkëlidhen këtij dokumenti.

Risitë dhe efektet e pritshme.

Miratimi i Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026 pritet të sjellë përmirësime në statistikat sektoriale, ku mund të përmendim:

Në Statistikat e Konsumit dhe Statistikat e Përdorimit të Kohës, pritshmëritë konsistojnë në:

- Krijimin e një baze të dhënash, të dokumentuar në një format të aksesueshëm, për gjenerimin e tabelave me rezultate të anketës sipas nevojave të përdoruesve;
- Kryerjen një herë në dhjetë vjet të anketës për përdorimin e kohës;

- Shtesën e treguesve statistikorë gjinorë.

Në Statistikat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, pritshmëritë konsistojnë në:

- Prodhimin e treguesve të rinj, lidhur me ndryshimet në nivel individual me kalimin e kohës, të vëzhguara në mënyrë periodike gjatë një periudhe 4 vjeçare;
- Publikimin e rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës edhe në nivel Rajonesh;
- Rindërtimin e të dhënave mikro, bazuar në legjislacionin e ri dhe rekomandimet e Eurostatit për zhvillimin e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2021 e në vazhdim;
- Matjen dhe raportimin e indeksit të privimit material të fëmijët;
- Analizën e treguesve që i përkasin një viti dhe të treguesve gjatë një periudhe 4 vjeçare;
- Ruajtjen e krahasueshmërisë me vendet e BE-së dhe përditësimin me ndryshimet metodologjike të Eurostatit;
- Botimin e një publikimi të veçantë me tregues që përshkruajnë cilësinë e jetës dhe situatën socio-ekonomike të popullsisë në vend;
- Ndërtimin e një fushe të re, të quajtur “Cilësia e Jetës”, ku përfshihen një sërë treguesish, si një kornizë gjithëpërfshirëse për matjen e mirëqenies nga Anketat Sociale dhe të dhënat administrative.

Në statistikat e sistemit të mbrojtjes sociale, pritshmëritë konsistojnë në:

- Zgjerimin e numrit të institucioneve furnizuese me të dhëna administrative;
- Rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera për përmirësimin e metodave të transmetimit të të dhënave të mbrojtjes sociale;
- Përgatitjen e një publikimi të dedikuar mbi treguesit e mbrojtjes sociale;
- Shtimin e treguesve të rinj të mbrojtjes sociale nga burimet ekzistuese të të dhënave administrative dhe të burimeve të reja furnizuese, përfshirë ato me fokus fëmijët;
- Hartimin dhe plotësimin e modulit për përfituesit e pensioneve, sipas metodologjisë së ESSPROS.
- Krijimin e sistemit bazë të ESSPROS;

- Klasifikimin e skemave të ESSPROS dhe të përfitimeve sociale, si dhe plotësimin e pyetësorit me të dhëna cilësore;
- Plotësimin e modulit për përfitimet neto të mbrojtjes sociale.

Në statistikat për drejtësinë dhe krimin, pritshmëritë konsistojnë në:

- Prodhimin e treguesve cilësorë dhe të krahasueshëm në fushën e drejtësisë dhe krimin;
- Prodhimin e treguesve cilësorë dhe të krahasueshëm për setin e zgjeruar të krimeve me interes në BE;
- Harmonizimin e definicioneve dhe rregullave të numërimit sipas ICCS;
- Formalizimin dhe zbatimin e Klasifikimit Ndërkombëtar ICCS;
- Llogaritjen e koeficientëve kryesorë për kriminalitetin dhe personat e përfshirë në sistemin e drejtësisë penale;
- Finalizimin e një Memorandumi Mirëkuptimi me Ministrinë e Drejtësisë;
- Hartimin e një publikimi të zgjeruar të treguesve në fushën e drejtësisë dhe krimin çdo 5 vite.

IV. Efektet financiare.

Të ardhurat për kryerjen e aktiviteteve të programit janë të parashikuara në buxhetet përkatëse të INSTAT-it, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Bankës së Shqipërisë, brenda tavaneve të përcaktuara në PBA 2022-2024.

V. Diskutimi në Komision.

Znj. Elsa Dhuli, Drejtore e Përgjithshme e Institutit të Statistikave, paraqiti Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026, duke vënë theksin në risitë që sjell, objektivat e Sistemit Kombëtar

Statistikor, si dhe kontributin që parashikohet të japë INSTAT-i dhe institucionet e tjera për të plotësuar nevojat e përdoruesve për statistika të besueshme dhe reale.

Znj. Anila Denaj, relatore e projektligjit, e vlerësoi mjaft të rëndësishëm Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026, i cili përcakton:

- Sfidat e programit të ri 2022-2026, si dhe qasjen krahasimore me programin 2017-2021, lidhur me aktivitetet përmirësuese në aspektin e metodologjisë, metodave të mbledhjes së të dhënave, afateve kohore dhe transmetimit të të dhënave në Eurostat;
- Objektivat zhvillimore të SKZ-së, masat për arritjen e tyre dhe indikatorët e monitorimit të performances;
- Aktivitetet statistikore, që do të kryhen nga prodhuesit e statistikave zyrtare gjatë pesë viteve, të ndara sipas fushave statistikore dhe të përcaktuara në shtojcën 1 të ligjit për statistikat zyrtare;
- Situatën e statistikave të nivelit vendor dhe vizionin e INSTAT-it për shtimin e treguesve të këtij niveli, me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave të institucioneve të vetëqeverisjes vendore;
- Institucionet e ngarkuara nga programi për prodhimin e statistikave zyrtare dhe numrin respektiv të aktiviteteve që do të kryejnë ato;
- Pasqyrimin e kuadrit rregullator, në të cilin mbështetet veprimtaria statistikore në vend;
- Sistemin e menaxhimit të cilësisë, për të garantuar prodhimin e statistikave cilësore në vend;
- Parashikimin e burimeve financiare dhe njerëzore të INSTAT-it, të nevojshme për zbatimin e programit;
- Analizën dhe menaxhimin e risqeve dhe problemeve të pritshme, të cilat kërkojnë marrjen e masave përkatëse parandaluese për të siguruar suksesin e zbatimit të programit.

Gjatë diskutimit, anëtarët e Komisionit vunë theksin në rolin e INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore për të publikuar statistika të sakta e të besueshme për qytetarët. Ata theksuan se vitet e fundit vërehet përmirësim i cilësisë së statistikave zyrtare dhe kërkuan që ky proces të vijojë e të thellohet më tej gjatë Programit të ri.

Znj. Elsa Dhuli iu përgjigj pyetjeve të relatores dhe të anëtarëve të tjerë të Komisionit për çështjet si më poshtë:

- *Lidhur me përllogaritjen nga INSTAT-i të statistikave në situatën aktuale të rritjes së çmimeve që po kalon vendi dhe e gjithë bota:*

INSTAT-i prodhon statistika zyrtare sipas metodologjive përkatëse, të përafruara me ato europiane. Këto statistika INSTAT-i i publikon në faqen e internetit të institucionit sipas një kalendari të posaçëm. Megjithatë, gjatë periudhës aktuale INSTAT-i ka përllogaritur edhe disa statistika eksperimentale, ku ka evidentuar luhatje të çmimeve në artikujt ushqimorë, karburantet etj.

- *Lidhur me ruajtjen e pavarësisë së institucionit nga presionet politike:*

INSTAT-i është një institucion i pavarur dhe profesional. Ai bashkëpunon me të gjitha institucionet publike dhe grupet e interesit, si dhe përdor të dhënat shkencore dhe sistemet *online*. Treguesit e cilësisë së statistikave zyrtare dhe të Anketës së Përdoruesve të tyre kanë evidentuar se është rritur besimi dhe kënaqësia e përdoruesve.

- *Lidhur me punën e kryer deri tani nga INSTAT-i për censin e popullsisë dhe të banesave:*

Si rezultat i tërmetit të muajit nëntor 2019, pandemisë Covid-19 dhe zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, aktiviteti i censit u shty për në tetor 2022. Deri tani janë kryer 3 teste, si dhe projekti i parë pilot, ku u testuan të gjitha fazat e censit. Për kryerjen e censit, do të rritet numri i punonjësve në organikën e INSTAT-it, si dhe do të punësohen edhe punonjës të tjerë me kontratë të përkohshme. Burimet për këtë shtesë punonjësish do të jenë nga buxheti i shtetit. Censi do të kryhet gjatë periudhës 1 tetor-15 nëntor 2022 dhe do të numërojë të gjithë popullsinë rezidente në vendin tonë.

- *Lidhur me fondet e BE-së që do të përdoren si burim për kryerjen e censit:*

Fondi i BE-së për financimin e censit do të mbahet në të njëjtin nivel me atë të parashikuar më parë, në vlerën 4.8 milionë lekë.

- *Lidhur me nivelin e trajnimit të stafit të INSTAT-it:*
Shkolla e Administratës Publike ka një strukturë trajnimi të gjithanshme. Kjo Shkollë do të kryejë edhe trajnimin e punonjësve të INSTAT-it, në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të tij.
- *Lidhur me trajtimin nga censi të çështjeve fetare:*
INSTAT-i ka organizuar takime me grupet e interesit, ku bëjnë pjesë edhe komunitetet fetare. Në këto takime janë shqyrtuar çështjet mbi pyetjet që do të ketë censi për përkatësinë fetare, kombësinë dhe gjuhën.
- *Lidhur me kërkesën për përshpejtimin e censit të bujqësisë, i cili pritet të ndihmojë në krijimin e regjistrit për këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë dhe në subvencionimin e fermerëve:*
Censi i bujqësisë ishte parashikuar të kryhej në vitin 2022, por u shty për në vitin 2024, si rezultat i shtyrjes së censit të popullsisë. Gjatë censit të popullsisë do të krijohet databaza. Në vitin 2023 do të kryhet testi pilot për censin e bujqësisë.

VI. Përfundim.

Komisioni është i mendimit se projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe respekton kërkesat e Rregullores për paraqitjen e tij në Kuvend. Për këto arsye, si dhe mbështetur në argumentet e evidentuara në mbledhje, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranshëm në mbledhje, me një ndryshim në aspektin e teknikes legjislativë, si më poshtë:

Në nenin 2 të projektligjit të vendoset titulli i tij “*Hyrja në fuqi*”.”.

RELATORJA
Anila DENAJ

KRYETARI
Eduard SHALSI